



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0178

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Batisha Ibrahimimi dhe Kimete Gashi - Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së OE "NBT -ING" SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “NDERTIMI DHE RENOVIMI I STACIONIT POLICOR RAHOVEC” me numër të prokurimit 214-25-6778-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS, më 20/04/2026, mori këtë:

Vendim

1. **Refuzohet**, si e pabazuar ankesa e "NBT -ING" SH.P.K. me nr. 2026/0178 , e datës 23/03/2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit “NDERTIMI DHE RENOVIMI I STACIONIT POLICOR RAHOVEC”, me numër të prokurimit 214-25-6778-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – POLICIA E KOSOVËS.
2. **Mbetet në fuqi** B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - POLICIA E KOSOVËS për aktivitetin e prokurimit “NDERTIMI DHE RENOVIMI I STACIONIT POLICOR RAHOVEC”, me numër të prokurimit 214-25-6778-5-1-1.
3. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 14.08.2025 POLICIA E KOSOVËS, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit “NDERTIMI DHE RENOVIMI I STACIONIT POLICOR RAHOVEC” me nr. të prokurimit: "214-25-6778-5-1-1"

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 664,033.85 €.

Me 06.03.2026 POLICIA E KOSOVËS., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin mbi vendimin për kontratë (B58), ku është rekomanduar për kontratë GOE “N.T Fer-Petroll -MBB Construction” SH.P.K.

Me 11.03.2026, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 13.03.2026 AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 23.03.2026, OE “NBT -ING” SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokoll 2026/0178, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, kundër njoftimit për dhenie të kontratës.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “NBT -ING” SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Kronologji

Ne, Grupi i Operatorëve Ekonomikë NBT-ING SH.P.K. & Agim Trolli B.I., kemi pranuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues (Formulari B58) të datës 05.03.2026, të nxjerrë nga Policia e Kosovës, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi dhe Renovimi i Stacionit Policor Rahovec – Rivlerësim”, me nr. të prokurimit 214-25-6778-5-1-1.

Si Operator Ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë të prokurimit, konsiderojmë se vendimi i Autoritetit Kontraktues për shpërblimin me kontratë të Grupit të Operatorëve Ekonomikë N.T. “Fer-Petroll”; MBB Construction SH.P.K., si dhe eliminimi i ofertës sonë nga procedura e vlerësimit, është marrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, dokumentet e dosjes së tenderit dhe parimet themelore të trajtimit të barabartë dhe transparencës në procedurat e prokurimit publik.

Vlen të theksohet se kjo procedurë është kthyer në rivlerësim me vendim të Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), me ç’rast Autoriteti Kontraktues ka qenë i obliguar të bëjë një rivlerësim të plotë, objektiv dhe në përputhje me arsyetimin e vendimit të OSHP, duke respektuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe dispozitat përkatëse të LPP-së. Megjithatë, nga analiza e vendimit të fundit të Autoritetit Kontraktues rezulton se rivlerësimi nuk është kryer në mënyrë të drejtë dhe të plotë, pasi që oferta jonë është eliminuar mbi bazën e një interpretimi të gabuar të procedurës së vazhdimit të validitetit të ofertës, ndërsa njëkohësisht është rekomanduar për kontratë një operator ekonomik i cili nuk përmbush në mënyrë të plotë kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit, veçanërisht në lidhje me përmbushjen e kriterëve për përvojë të ngjashme dhe dëshmimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale.

Në këto rrethana, konsiderojmë se vendimi i Autoritetit Kontraktues është rezultat i një interpretimi të gabuar të kërkesave të dosjes së tenderit dhe i një vlerësimi jo të plotë të ofertave, gjë që bie ndesh me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, në veçanti me parimet e trajtimit të barabartë, transparencës dhe vlerësimit të drejtë të ofertave. Për këto arsye, përmes kësaj kërkesë për rishqyrtim kërkujmë që Autoriteti Kontraktues të rishqyrtojë vendimin e marrë, të anulojë vendimin për shpërblim me kontratë dhe të bëjë një rivlerësim të drejtë dhe të plotë të ofertave në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik dhe dokumentet e tenderit.

1. Argumenti i AK për eliminimin e ofertës sonë dhe kundërshtimi i tij:

Sa i përket arsyes së eliminimit të Grupit të Operatorëve Ekonomikë NBT-ING SH.P.K. & Agim Trolli B.I., përkatësisht konstatimit të Autoritetit Kontraktues se OE nuk ka bërë vazhdimin e validitetit të ofertës dhe sigurimit sipas kërkesës së AK të datës 29.12.2025, konsiderojmë se ky konstatim është i pabazuar, si në aspektin juridik ashtu edhe në aspektin faktik.

Së pari, duhet theksuar se kjo procedurë është kthyer në rivlerësim me vendim të OSHP-së, me ç'rast Autoriteti Kontraktues ka qenë i obliguar të bëjë një rivlerësim të plotë dhe objektiv të ofertave. Në këtë situatë, eliminimi i operatorit ekonomik vetëm mbi bazën e një elementi procedural të mëhershëm, pa një rivlerësim real të ofertës dhe pa marrë parasysh rrethanat aktuale të procedurës, nuk është në përputhje me qëllimin dhe efektin juridik të vendimit të OSHP-së.

Së dyti, Grupi i Operatorëve Ekonomikë NBT-ING SH.P.K. & Agim Trolli B.I. është i gatshëm dhe në gjendje të bëjë vazhdimin e vlefshmërisë së ofertës dhe të sigurimit të ofertës sipas kohëzgjatjes së kërkuar nga Autoriteti Kontraktues, dhe në kuadër të kësaj kërkesë për rishqyrtim do të paraqesë edhe vazhdimin përkatës të validitetit të ofertës dhe sigurimit. Kjo dëshmon qartë se oferta jonë mbetet valide dhe e garantuar sipas kërkesave të dosjes së tenderit.

Së treti, qëllimi i kërkesës për validitet të ofertës dhe sigurim nuk është eliminimi formal i operatorëve ekonomikë kur ata janë në gjendje të sigurojnë vazhdimin e tyre, por garantimi që oferta të mbetet e vlefshme gjatë procedurës së prokurimit. Në këtë rast, duke qenë se OE ka bërë dhe po paraqet vazhdimin e vlefshmërisë së ofertës dhe sigurimit sipas kërkesës së AK, arsyeja e eliminimit nuk qëndron dhe si e tillë duhet të rishqyrtohet.

Për këto arsye, konsiderojmë se eliminimi i Grupit të Operatorëve Ekonomikë NBT-ING SH.P.K. & Agim Trolli B.I. mbi këtë bazë është i pabazuar dhe kërkujmë që Autoriteti Kontraktues ta anulojë këtë konstatim dhe ta përfshijë ofertën tonë në një rivlerësim të drejtë dhe të plotë të ofertave, në përputhje me vendimin e OSHP-së dhe me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik.

2. Argumenti i AK për dhënien e kontratës dhe kundërshtimi i tij:

Sa i përket vendimit të Autoritetit Kontraktues për shpërblimin me kontratë të Grupit të Operatorëve Ekonomikë N.T. "Fer-Petroll"; MBB Construction SH.P.K., konsiderojmë se ky vendim është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me gjetjet dhe konstatimet e vetë Autoritetit Kontraktues të evidentuara gjatë procedurës së vlerësimit.

Nga dokumentacioni zyrtar i nxjerrë nga Autoriteti Kontraktues (letra standarde B42 për tenderuesin e eliminuar) rezulton se për të njëjtin Operator Ekonomik AK ka konstatuar se oferta e tij është administrativisht e papërgjegjshme, pasi që OE nuk ka arritur të dëshmojë

përmbushjen e kërkesave të Dosjes së Tenderit në lidhje me përvojën e ngjashme. Konkretisht, sipas vetë gjetjeve të Autoritetit Kontraktues, operatori ekonomik nuk ka arritur të dëshmojë kontrata të përfunduara të natyrës së njëjtë në vlerën minimale të kërkuar sipas Dosjes së Tenderit, ku nga lista e kontratave të paraqitura janë pranuar vetëm kontrata në vlerë totale rreth 284,710 €, që është dukshëm më e ulët se kërkesa minimale e përcaktuar prej 800,000 €, duke konstatuar qartë se OE nuk e plotëson këtë kriter të rëndësishëm të kapacitetit teknik dhe profesional.

Në këto rrethana, është juridikisht e pakuptueshme që i njëjti Operator Ekonomik, i cili sipas gjetjeve të vetë Autoritetit Kontraktues nuk përmbush kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe është cilësuar si administrativisht i papërgjegjshëm, të rekomandohet për shpërblim me kontratë. Një veprim i tillë krijon një kundërthënie të qartë ndërmjet konstatimeve faktike të Autoritetit Kontraktues dhe vendimit përfundimtar për shpërblimin e kontratës, duke e bërë vendimin e fundit të pabazuar dhe juridikisht të paqëndrueshëm.

Për më tepër, edhe në aspektin ekonomik vendimi i Autoritetit Kontraktues është i pajustificuar. Oferta e Grupit të Operatorëve Ekonomikë NBT-ING SH.P.K. & Agim Trolli B.I. është dukshëm më e favorshme për Autoritetin Kontraktues, me vlerë prej 488,546.40 €, ndërsa oferta e OE të rekomanduar për kontratë është në vlerë 518,765.00 €, pra rreth 30,000 € më e lartë se oferta jonë.

Në përputhje me parimet themelore të Ligjit për Prokurimin Publik, Autoriteti Kontraktues është i obliguar të sigurojë përdorimin sa më ekonomik dhe efikas të fondeve publike dhe të shpërblejë kontratën për ofertën ekonomikisht më të favorshme që përmbush të gjitha kërkesat e Dosjes së Tenderit. Në këtë rast, përveç se oferta jonë është më e ulët dhe më ekonomike, Autoriteti Kontraktues vetë ka konstatuar se OE i rekomanduar nuk përmbush kriteret e kërkuara në Dosjen e Tenderit. Për rrjedhojë, vendimi për shpërblimin e kontratës jo vetëm që është ekonomikisht i pafavorshëm për Autoritetin Kontraktues, por është edhe juridikisht i pabazuar.

Për këto arsye, bazuar në gjetjet e vetë Autoritetit Kontraktues dhe në krahasimin objektiv të ofertave, konsiderojmë se vendimi për shpërblimin me kontratë të OE N.T. "Fer-Petroll"; MBB Construction SH.P.K. është marrë në kundërshtim me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe me parimet e Ligjit për Prokurimin Publik, dhe si i tillë duhet të anulohet dhe të bëhet një rivlerësim i drejtë dhe i plotë i ofertave.

Nga dokumentacioni zyrtar i nxjerrë nga Autoriteti Kontraktues rezulton qartë se operatori ekonomik i rekomanduar nuk ka arritur të dëshmojë përmbushjen e kërkesave të Dosjes së Tenderit në lidhje me përvojën e ngjashme, ndërkohë që oferta e Grupit të Operatorëve Ekonomikë NBT-ING SH.P.K. & Agim Trolli B.I. është ekonomikisht më e favorshme dhe plotëson kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit. Në këto rrethana, vendimi për shpërblimin e kontratës nuk është në përputhje me parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe përdorimit ekonomik të fondeve publike, të përcaktuara në Ligjin për Prokurimin Publik.

Prandaj, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që në kuadër të kompetencave të tij ligjore:

të pranojë këtë ankesën si të bazuar;

të anulojë vendimin për shpërblimin e kontratës; dhe

të bëjë rivlerësim të plotë të ofertave në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik.

Në këtë aktivitet të prokurimit nuk është bërë ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së, sepse oferta jonë është e përgjegjshme dhe i plotëson të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Përgjigja në pretendimet ankimore të OE "Grup i Operatorëve Ekonomik NBT-ING SH.P.K. & AGIM TROLLI B.I., Kosovë"

Operatori Ekonomik në kërkesën për rishqyrtim nuk ka dhënë fakte apo argumente të mjaftueshme për të treguar pse janë shkelur nenet e mëposhtme: Neni 1 i LPP-së / Qëllimi, Neni 6 i LPP-së / Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, Neni 7 i LPP-së / Barazia në Trajnim / Jo-Diskriminim, Neni 59 i LPP-së / Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, Neni 60 i LPP-së / Kriteret për dhënien e kontratës, Neni 61 i LPP-së, Neni 64 i LPP-së / Dëshmitë e kërkesave, Neni 66 i LPP-së, Neni 69 i LPP-së, Neni 72 i LPP-së / Dokumentacioni dhe informacioni shtesë, RREGULLORE NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK, Neni 25 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik, Nenet 40, 41, 60, 64 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik dhe Neni 10 i Udhëzuesit Nr.001/2023 për Prokurim Publik (me ndryshimet e 002/2024).

Megjithatë, OE ka ankimuar vetëm arsyet e eliminimit dhe pikat e rekomanduarit për kontratë, për të cilat Autoriteti Kontraktues (AK) në vijim jep përgjigje për secilën pikë të ankesës mbi faktet dhe argumentet që dëshmojnë se AK në asnjë rrethanë nuk ka shkelur ndonjë nen të LPP-së apo të Rregullores për Prokurim Publik.

Komisioni i ri-vlerësimit, në harmoni të plotë me Nenin 59 të LPP-së dhe Nenin 40 të Rregullores për Prokurim Publik, ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve të Grupit të Operatorëve NBT-ING SH.P.K. & AGIM TROLLI B.I.

AK, duke u bazuar në Rregulloren dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik, Neni 30 / Validiteti i Tenderit, paragrafi 4, ka kërkuar zgjatjen e validitetit dhe sigurimit të tenderit për periudhën prej 90 ditësh për validitetin dhe 120 ditësh për sigurimin e tenderit. Me datën 29.12.2025, AK ka ngarkuar në sistem kërkesën për vazhdim të validitetit dhe sigurimin e tenderit. OE nuk ka vazhduar validitetin e ofertës dhe sigurimin e tenderit.

AK njofton, duke u bazuar në Nenin 30.6 të RREGULLORES NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK, se Grupit të Operatorëve NBT-ING SH.P.K. & AGIM TROLLI B.I., në fazën e rivlerësimit, nuk i ka qenë pale e interesit, sepse në kohën kur është rivlerësuar aktiviteti, oferta e tyre nuk ka qenë valide dhe as sigurim i tenderit nuk ka pasur. Sipas Nenit 30.6, është e hapur për secilin OE të vendosë nëse dëshiron të zgjatë validitetin e tenderit, dhe operatorët që vendosin të mos zgjasin validitetin e tenderëve të tyre do të refuzohen si "të papërgjegjshëm", pa ndonjë konfiskim të sigurimit të tenderit të tyre. Andaj, ky pretendim është i pabazuar.

Pretendimi ankimor që Grupit të Operatorëve N.T. "Fer-Petroll"; MBB Construction SH.P.K. i është rekomanduar për kontratë nga AK në kundërshtim me LPP-në nuk qëndron. AK sqaron se kjo pikë nuk është e vërtetë, pasi sipas vendimit të OSHP-së nr. 2025/1200, të datës 16.02.2026,

OE është konsideruar i përgjegjshëm për pikat për të cilat ishte eliminuar nga AK. Andaj, ky pretendim është gjithashtu i pabazuar.

Mbi bazën e të gjitha argumenteve të përmendura më sipër, refuzohet kërkesa për rishqyrtim e OE, pasi pretendimet ankimore nuk qëndrojnë. Policia e Kosovës, në përputhje me Nenin 108/A, paragrafi 10.1, refuzon kërkesën e propozuar për shqyrtim si të pabazuar.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me date 27.03.2026 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2026/0178, ndërsa me datë 02.04.2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2026/0178, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues-teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK është përgjigjur rreth rekomandimit të raportit të ekspertit shqyrtues, po ashtu as OE nuk është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE“NBT -ING” SH.P.K, eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0178 ka vlerësuar si në vijim:

Autoriteti Kontraktues Policia e Kosovës, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës punë. Vlera e parashikuar 664,033.85 €. Kriteret e Dhënies së kontratës Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët.

Sqarim hyrës: Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër njoftimit për dhënie të kontratës, konkretisht kundër ofertës së grupit të operatorëve ekonomik të rekomanduar për kontratë N.T.”Fer-Petroll; MBB Construction”shpk.

Kjo procedurë e prokurimit, më herët ka qenë objekt i shqyrtimit pranë OSHP-së për shkak se AK e kishte anuluar këtë procedurë të prokurimit, ndërsa tani OE fitues N.T. “Fer-Petroll; MBB Construction” Sh.p.k. kishte parashtruar ankesë kundër vendimit të AK për anulim të këtij aktiviteti të prokurimit. Pas pranimit të ankesës në OSHP, ishte trajtuar ankesa nga eksperti shqyrtues paraprak, i cili ka nxjerr raport të ekspertizës me Nr.2025/1200. Gjithashtu, Paneli Shqyrtues ka gjykuar me Vendimin nr.PSH.nr.2025/1200, të datës 16.02.2026, duke e aprovuar si të bazuar ankesën e OE tani të rekomanduar për kontratë N.T.”Fer-Petroll; MBB Construction” Sh.p.k., kurse ka anuluar njoftimin mbi vendimin e AK-së, dhe lëndën e ka kthyer në rivlerësim.

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore, sqarojmë se operatori ekonomik ankues GOE “NBT-ING” shpk& Agim Trolli B.I.” pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 59, 60, 61, 64, 66, 69 dhe 72 të LPP-së, si dhe nenin 25, 40, 41, 60 dhe 64 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik, si dhe nenin 10 të Udhëzuesit Nr.001/2023 për Prokurim Publik. Pretendimet e ngritura ankimore nga ana e operatorit ekonomik ankues janë shqyrtuar nga ekspertja shqyrtuese duke u bazuar në shkresat e lëndës dhe jep përgjigjet si në vijim.

Pretendimi ankimor 1: Sipas B42 “Letrës standarde për tenderuesit e eliminuar” të datës 05.03.2026 OE ankues “NBT-ING” shpk & Agim Trolli B.I.”, është eliminuar me arsyetimin si vijon: *“Grupi i OE eshte i papërgjegjshëm pasi nuk ka bere vazhdimin e validitetit të ofertës dhe sigurimin sipas kërkesës së AK të datës 29.12.2025.”* OE ankues “NBT-ING” shpk& Agim Trolli B.I, e kundërshton eliminimin nga AK me arsyetimin se kjo procedurë është kthyer në rivlerësim me vendim të Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), me ç ‘rast Autoriteti Kontraktues ka qenë i obliguar të bëjë një rivlerësim të plotë dhe objektiv të ofertave. Në këtë situatë, eliminimi i operatorit ekonomik vetëm mbi bazën e një elementi procedural të mëhershëm, pa një rivlerësim real të ofertës dhe pa marrë parasysh rrethanat aktuale të procedurës, nuk është në përputhje me qëllimin dhe efektin juridik të vendimit të OSHP. Tutje, OE ankues pretendon se është i gatshëm dhe në gjendje të bëjë vazhdimin e vlefshmërisë së ofertës dhe të sigurimit të ofertës sipas kohëzgjatjes së kërkuar nga Autoriteti Kontraktues, dhe në kuadër të kësaj kërkesë për rishqyrtim do të paraqesë edhe vazhdimin përkatës të validitetit të ofertës dhe sigurimit. Kjo dëshmon qartë se oferta jonë mbetet valide dhe e garantuar sipas kërkesave të dosjes së tenderit. OE ankues shton se qëllimi i kërkesës për validitet të ofertës dhe sigurim nuk është eliminimi formal i operatorëve ekonomikë kur ata janë në gjendje të sigurojnë vazhdimin e tyre, por garantimi që oferta të mbetet e vlefshme gjatë procedurës së prokurimit. Në këtë rast, duke qenë se OE ka bërë dhe po paraqet vazhdimin e vlefshmërisë së ofertës dhe sigurimit sipas kërkesës së AK, arsyeja e eliminimit nuk qëndron dhe si e tillë duhet të rishqyrtohet.

Përgjigje në pretendimin ankimor 1: Bazuar në shkresat e lëndës, të cilat janë të ngarkuara në platformën e-prokurimit për këtë aktivitet të prokurim, ekspertja shqyrtuese sqaron se AK me datë 29.12.2025, i’u është drejtuar operatorëve ekonomik me kërkesë për zgjatjen e validitetit të ofertave për periudhën prej 90 ditësh, si dhe zgjatjen e sigurimit të tenderit për 120 ditë nga data e skadimit të sigurimit të tenderit. Gjithashtu, AK ka kërkuar që konfirmimi për vazhdimin e vlefshmërisë dhe sigurimit të ofertës të dorëzohet përmes platformës elektronike brenda afatit, konkretisht deri më 31.12.2025, ora 16:00. Ekspertja shqyrtuese sqaron se bazuar në shkresat e lëndës në platformën e-elektronike të prokurimit, OE ankues “NBT-ING” shpk& Agim Trolli B.I.”, nuk i është përgjigjur kërkesës së AK-së, pra nuk ka dorëzuar konfirmimin për vazhdimin e validitetit të ofertës dhe sigurimin e tenderit brenda afatit të përcaktuar nga AK. Vlen të theksohet se për këtë aktivitet të prokurimit kanë marrë pjesë pesë (5) operatorë ekonomik, ku katër (4) prej tyre, duke e përfshirë edhe tani OE ankues, nuk i janë përgjigjur kërkesës së AK-së të datës 29.12.2025 për vazhdimin e validitetit të ofertës dhe sigurimin e tenderit. Si pasojë e mos përgjigjes së operatorëve ekonomik, AK i ka vlerësuar si oferta të “papërgjegjshme” konform nenit 30 paragrafi 6 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik.

Ekspertja shqyrtuese vlerëson se përderisa AK i është drejtuar operatorëve ekonomik me kërkesë për vazhdim të validitetit të ofertave dhe zgjatje të afatit të sigurimit të tenderit, ka përmbushur kërkesën ligjore ashtu siç është përcaktuar në Rregulloren nr. 001/2022 për Prokurim Publik,

Neni 30, paragrafi 4, ku përcaktohet se AK do të kërkoj nga Operatorët Ekonomik të zgjasin validitetin e tenderëve të tyre. Për më tepër, neni 30, paragrafi 6 i kësaj Rregulloreje, përcakton se operatorët ekonomikë që refuzojnë ose nuk përgjigjen për zgjatjen e validitetit të ofertës, konsiderohen si “të papërgjegjshëm”. Duke u bazuar në dispozitat e cekura si më lartë, mos zgjatja e validitetit dhe sigurimit të tenderit nga operatorët ekonomik rezulton më refuzim nga procedura si ofertë e “papërgjegjshme”. Andaj, pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Pretendimi ankimor 2: OE ankues “NBT-ING” shpk& Agim Trolli B.I.” pretendon se vendimi i AK-së, për shpërblim me kontratë të GOE N.T. “Fer-Petroll; MBB Construction” Sh.p.k. është në kundërshtim me gjetjet dhe konstatimet e vet autoritetit kontraktues, pasi oferta e tij është shpallur administrativisht e papërgjegjshme dhe për të njëjtin është konstatuar se nuk arrin të dëshmon përmbushjen e kërkesave të DT në lidhje me përvojën e ngjashme. Tutje, OE ankues potencon se është juridikisht e pakuptueshme që i njëjti Operator Ekonomik, i cili sipas gjetjeve të vet autoritetit kontraktues nuk përmbush kërkesat e dosjes së tenderit dhe është cilësuar si administrativisht i papërgjegjshëm, të rekomandohet për shpërblim me kontratë. Një veprim i tillë krijon një kundërtënie të qartë ndërmjet konstatimeve faktike të autoritetit kontraktues dhe vendimit përfundimtar për shpërblimin e kontratës, duke e bërë vendimin e fundit të pabazuar dhe juridikisht të paqëndrueshëm. Për më tepër, edhe në aspektin ekonomik vendimi i autoritetit kontraktues është i pajustificuar. Oferta e grupit të operatorëve ekonomik NBT-ING SH.P.K. & Agim Trolli B.I. është dukshëm më e favorshme për Autoritetin Kontraktues, me vlerë prej 488,546.40 €, ndërsa oferta e OE të rekomanduar për kontratë është në vlerë 518,765.00 €, pra rreth 30,000 € më e lartë se oferta jonë.

Përgjigje në pretendimin ankimor 2: Ekspertja shqyrtuese sqaron se për këtë procedurë të prokurimit është nxjerr një vendim me nr.PSH.nr.2025/1200, të datës 16.02.2026, ku është aprovuar si e bazuar ankesa e OE N.T. “Fer-Petroll; MBB Construction” Sh.p.k., është anuluar vendimi i AK-së për anulim të procedurës së prokurimit, si dhe lënda është kthyer në rivlerësim. Meqenëse ankesa ishte aprovuar si e bazuar, nënkuptohet që pretendimet ankimore të ankuesit, tani OE të rekomanduar për kontratë janë trajtuar si pretendime ankimore të bazuara, ku në mesin e pretendimeve ka qenë edhe çështja e përvojës së ngjashme të cilën e konteston OE ankues. Pas nxjerrjes së vendimit të OSHP-se, dhe kthimit të lëndës në rivlerësim, si dhe bazuar në shkresat e lëndës, konkretisht “Raporti i Vlerësimit te tenderve.pdf” të datës 06.03.2026 14:20 “oferta e GOE N.T.”Fer-Petroll; MBB Construction” Sh.p.k., është shpallur ofertë e përgjegjshme dhe është rekomanduar për kontratë. Pra, për vlerësimin e ekspertës shqyrtuese, AK ka zbatuar vendimin PSH.nr.2025/1200, të datës 16.02.2026.

Sa i përket pikës ankimore të OE ankues që potencon se oferta e tyre është dukshëm më e favorshme për Autoritetin Kontraktues, me vlerë prej 488,546.40€, ndërsa oferta e OE të rekomanduar për kontratë është në vlerë 518,765.00 €, pra rreth 30,000 €, më e lartë se oferta jonë, ekspertja shqyrtuese vlerëson se përderisa OE ankues nuk ka bërë vazhdimin e validitetit të ofertës dhe vazhdimin e sigurimit të tenderit, oferta e tyre refuzohet si e “papërgjegjshme” konform nenit 30.4 të Rregullores. Andaj, pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Në mbështetje të asaj që u përshkrua si më lartë, rekomandoj që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pa bazuar për arsyet e dhëna në përgjigjet ndaj pretendimeve ankimore. Andaj, rekomandimi ynë është që Autoriteti Kontraktues ta mbaj në fuqi njoftimin mbi vendimin e datës 06.03.2026.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues mendimet e tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të pabazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur të mbetet në fuqi njoftimi mbi vendimin për dhenie të Autoritetit Kontraktues POLICIA E KOSOVËS, lidhur me aktivitetin e prokurimit “NDERTIMI DHE RENOVIMI I STACIONIT POLICOR RAHOVEC”, me numër të prokurimit 214-25-6778-5-1-1.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - POLICIA E KOSOVËS**
- **OE - "NBT -ING" SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: